



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:270413
Datë: 12.04.2024
Numri i dokumentit: 05565431

C-IV-14-6030
Parashtruesi i kërkesës

R V të cilin e përfaqëson avokat S K nga Lipjani

Kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) (NSH “Termovent” në likuidim), Rr. “Dritan Hoxha” nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 12 prill 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- I. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN045-0105 datë 4 gusht 2014.**
- III. Secila palë i mbulon shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 1 shtator 2014, ankuesi pranë DHPGJS, parashtron një kërkesë, të emërtuar ankesë, për rishqyrtimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PRN045-0105 datë 4 gusht 2014 (tani e tutje Vendimi), me të cilin i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për paga të papaguara për periudhën nga data 5 prill 1991 e gjer me 30 mars 1997, në shumë prej 37,224.08 Dinarë, përfshirë edhe kamatën ligjore duke filluar nga data 11 dhjetor 1997 e gjer në pagesën definitive, ndaj NSH “Termovent” (në likuidim).

Sipas Vendimit të AL, kërkesa e ankuesit është refuzuar për shkak të parashkrimit.

Ankuesi kundërshtoj Vendimin e AL, për shkak të vendimit mbi refuzimin e kërkesës si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave materiale.

Ankuesja të drejtën e tij e mbështetet në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Lipjan, P.br. 360/97 datë 11 dhjetor 1997. Sipas këtij aktgjykimi, NSH “Termovent” është obliguar që emër të pagave të humbura për periudhën 5 prill 1991 e gjer me 30 mars 1997, ankuesit ti paguaj shumën prej 37,224.08 Dinarë të atëhershëm, përfshirë edhe kamatën ligjore duke filluar prej datë 11 dhjetor 1997 (në tekstin në vijim AKTGJYKIMI).

Ankuesi gjithashtu kundërshtoj Vendimin e AL, sa i përket dispozitave ligjore lidhur me parashkrimin e kërkesës sepse në rastin konkret është dashur të zbatohen dispozitat ligjore të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve, neni 379 (në tekstin në vijim LMD) e jo edhe Ligji për punën e bashkuar (në tekstin në vijim LPB).

Ankuesi tutje pohoj se mos ekzistimi i klauzolës së plotfuqishmërisë nuk e determinon rrjedhën e afatit të parashkrimit sepse sipas ankuesit nga shkresat e gjykatës, që e ka lëshuar këtë aktgjykim, nuk ka prova që aktgjykimi i është dorëzuar palës së kundërt, në këtë rast NSH. Nga gjitha arsyet i propozon gjykatës, që nga gjitha provat e parashtruara, të aprovoj kërkesën e ti mbi pagat e pa-paguara.

Kërkesës për rishikim i janë bashkangjitur:

- Kopja e Autorizimit për përfaqësuesin,
- Kopjen e AKTGJYKIMIT,
- Kopja e Vendimit të AL,
- Kopje e shkresës drejtuar AKP,
- Kopjen e shkresës së AKP drejtuar ankuesit, datë 3 korrik 2014, mbi të dhënat shtesë lidhur me kërkesën kreditore, dhe
- Kopjen e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Serbisë, Rev. 2297/96 datë 27 maj 1997.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 10 tetor 2022, parashtroj përgjigjen.

AKP kundërshtoj kërkesën për rishikim duke e konsideruar si të pabazuar. AKP pohon se AL ka bërë vlerësim të drejtë të gjendjes faktike e po ashtu edhe dispozitat ligjore i ka zbatuar në mënyrë të drejtë. AKP tutje mbështet Vendimin se kërkesa e ankuesit konsiderohet e pabazuar respektivisht e parashkruar sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. Nga gjitha arsyet propozon që kërkesa për rishikim të refuzohet si e pabazuar dhe Vendim i AL të vërtetohet.

Përgjigjes i është bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL.

Përgjigja e AKP ju dorëzua përfaqësuesit të ankuesit me 20 tetor 2022.

Nuk u parashtrua përgjigje.

Arsyetimi Ligjor

Kërkesa për rishikim-ankesa konsiderohet e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Në rastin konkret, ankuesi pretendon të drejtën në përmbushjen e obligimeve nga marrëdhënia e punës duke u bazuar në AKTGJYKIM.

Aktgjykimi, ashtu siç edhe vetë ankuesi pohon në kërkesën e tij për rishikim-ankesë, nuk e përmban vulën e plotfuqishmërisë sepse nuk ka prova që pala e kundërt në këtë rast e ka pranuar AKTGJYKIMIN. Kjo nënkupton se nuk janë shtjerë të gjitha mjetet e lejuara juridike,

Nga e gjithë kjo rrjedh dhe gjykata konsideron se AKTGJYKIMI nuk është i formës së prerë dhe përfundimtar andaj edhe nuk paraqet titull ekzekutiv dhe të përmbarueshëm.

Andaj nga gjitha arsyet e cekura ligjore, gjykata konsideron se kërkesa e ankuesit nuk i ka plotësuar kushtet ligjore me të cilat do ti kompensohej kërkesa mbi pagat.

Nga gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Obiter dictum (ndër të tjerash)

Po sikur edhe të ishte i formës së prerë përmbareueshëm, gjë që nuk është, në rastin konkret sipas nenit 608 në paragrafin 2 të LPB lidhur me nenin 379 të LMD (gazeta zyrtare e RSFJ nr 29/78 me plotësime e ndryshime 39/85; 45/89) kërkesa e ankuesit do të konsiderohej e parashkruar. Në këtë thuhet, citat:

“Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim”.

Edhe me LMD të Kosovës nr. 04/L-077, ligj ky në fuqi në momentin e lëshimit të Vendimit nga ana e AL, me nenin 361 parashihet i njëjti afat dhe e njëjta situatë e parashkrimit të kërkesave.

Në rastin konkret ankuesi i është drejtuar AL, jashtë procedurës gjyqësore, për përmbushjen e një obligimi i cili rrjedh sipas vendimit të vitit 1997.

Nga dispozitat e cekura si më lartë, e lidhur me nenet po ashtu të cituara si më lartë (379 respektivisht 361), nga koha e veprimit të fundit 11 dhjetor 1997 (AKTGJYKIMI), kur edhe fillon edhe llogaritja e afatit të fundit, e gjer me 14 nëntor 2013 – koha e paraqitjes së kërkesës kreditore pranë AL, si veprim i ardhshëm vijues, kanë kaluar 16 vite, andaj do të konsiderohet se afati i parashkrimit është plotësuar.

Për më tepër edhe pse në rastin konkret gjithashtu nuk është çështja, edhe në procedurën e përmbarimit, sipas Ligjit nr. 04/L-139 për procedurën e përmbarimit, ligjvënësi parasheh edhe institutin e parashkrimit. Procedura e filluar e përmbarimit gjithashtu mund të konsiderohet e parashkruar dhe në rastet dhe në situatë të tilla procedura duhet të konsiderohet e përfunduar, Neni 66 paragrafi 3, thekson se: *“Përmbarimi do të përfundohet edhe kur ai është bërë i pamundshëm apo kur nga shkaqe të tjera nuk mund të zbatohet, si dhe pas kalimit të afatit absolut të parashkrimit për përmbarim”*.

Taksa Gjyqësore

Kërkesa e ankuesit rrjedh nga marrëdhënia e punës.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshillë Juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar